

Nr. 1201/3 Prot.

Lezhë, më 24/10 /2023

PROCESVERBAL
PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR PBA-NË 2024-2026 DHE BUXHETIN VJETOR 2024,
SI DHE PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE

I mbajtur me datë 19.10.2023 në orën 17:00 në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Gjergj Lacaj” Lezhë, në vijim të njoftimit të publikuar në Web, përkatësisht në linkun <https://lezha.gov.al/konsultim-publik-per-pba-ne-2024-2026-buxhetin-vjetor-si-dhe-taksat-e-tarifat-vendore/>, me prezencën e panelit prej 5 anëtarësh:

1. Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Pjerin Ndreu,
2. Zv.Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Ermal Pacaj,
3. Zv.Kryetares së Bashkisë Lezhë- Znj.Eueda Molla,
4. Kryetarit të Këshillit Bashkiak Lezhë -Z.Ndue Luli,
5. Administratorit të Njesisë Administrative Shëngjin- Z.Brahim Demi,

drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe në prezencën e banorëve të njësive administrative Shëngjin, Lezhë, përfaqësues nga shoqëria civile, bizneset, anëtarë të Këshillit Bashkiak Lezhë etj.

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili vendosi theksin në temën e takimit duke pritur sygjerime, propozime në lidhje me buxhetin dhe taksat për vitin 2024. Në fjalën e tij shprehu që paketa fiskale nuk ka pësuar ndryshime, nuk do të ketë rritje taksash edhe pse mund të ishte operuar me rritjen e tyre. Bashkia Lezhë ka nivelin më të ulët të taksave në Shqipëri. Janë ulur shumica e taksave në masën 20-30%. Qëllimi ka qenë zgjerimi i bazës së taksapaguesve. Kryetari shprehu se gjatë procesit është evidentuar se biznese me sipërfaqe të ndryshme kanë paguar të njëjtat taksa dhe pas verifikimit në terren ka patur raste që për biznese të caktuara është rritur ose ulur vlera që duhet të paguanin. Një problem i identifikuar është se administrata tatimore nuk ka mundur të sigurojë një database të plotë e për pasojë është ngritur një platformë digjitale por gjithashtu do të aplikohet edhe sistemi i vetëdeklarimit. Gjithashtu bllokimi i lejeve të ndërtimit ka krijuar një ngërç. Bashkia është një strukturë që administron taksat. Kryetari i Bashkisë përmendi se pavarësisht problematikave dhe sfidave, është ulur niveli i borxheve të mbartura dhe parashikohet që vitin e ardhshëm me mbledhjen e të ardhurave do kapërcehen borxhet dhe bilanci do të jetë pozitiv. Projektbuxheti do të hartohet sipas problematikave të evidentuara dhe nevojave të komunitetit, duke marrë parasysh mendimet e të pranishmëve.

Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore paraqiti situatën në faturim dhe gjenerim të ardhurash për qytetin e Lezhës dhe njesinë administrative Shëngjin, si dhe pikat të cilat kanë nevojë për ndryshim por pa ndikuar në rritjen e taksave. Në prezantimin e tij evidentoi që regjistri i taksapaguesve përbëhet nga taksapagues biznes, pronar posedues të sipërfaqeve të ndërtimit për qëllime ekonomike dhe taksapagues familjarë. Rezultojnë të jenë 13,584 familje të taksueshme për 2 njësitë, tek Ujësjellës Kanalizime Lezhë janë 15,220 abone dhe janë më shumë sepse ka banesa të dyta ose të treta. Të ardhurat totale që gjenerohen janë 57 milion lekë, taksë pasurie dhe tarifa shërbimesh së bashku ndërsa sipas llogarive kapaciteti financiar te kjo zonë është rreth 68 milion. Problemi kryesor që ndeshet me abonentët familjarë është taksë e pasurisë. Sipas drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2024 është vendosur objektiv të unifikohej sistemi i taksapaguesve familjarë, regjistri që ka bashkia me atë që disponon ujësjellësi, së bashku me detyrimet që mund të jenë të mbartura ndër vite. Synohet një taksim i drejtë nëpërmjet vetëdeklarimit të qytetarit, të mos ketë rritje taksash por të rritet numri i taksapaguesve. Shembull i një familje në këtë zonë me një pronë me sipërfaqe 100 m² truall dhe 100 m² ndërtim së bashku me tarifën e shërbimit do të ketë kosto rreth 5,000 lekë të reja në vit. Grupet në nevojë, pensionistët dhe banesat sociale përjashtohen totalisht nga pagesa e këtyre detyrimeve. Drejtori shprehu se është krijuar një platformë e digjitalizuar ku çdo biznes do të ketë accountin e vet dhe do të mund të komunikojë me Drejtorinë e Taksave. Tarifimi i shërbimeve publike bëhet mbi bazën e xhiros vjetore dhe aktivitetit që kryen biznesi. E njëjta problematikë për taksën e pronës ndeshet edhe me biznesin ku janë 300 biznese të cilat pavarësisht njoftimit nuk janë përgjigjur, prandaj është propozuar që t'u vendoset afat deri me 31 janar e në të kundërt do ketë penalitete. Në shembullin e tarifimit të një biznesi të vogël me 100 m² truall dhe 100 m² pronësi pagesa do të ishte në total 28,900 lekë në vit ndërsa në rastin e një biznesi të madh 413,900 lekë në vit. Sipas të dhënave mbi faturimin në këtë zonë janë 2,816 njesi ekonomike të cilat gjenerojnë një total faturimi rreth 208 milion lekë.

Specialisti i IT-së shpjegoi sesi do të funksionojë sistemi i taksave të bashkisë i cili do jetë i publikuar në WEB-in lezha.gov.al përkatësisht në modulën "Taksat e mia" ku secili mund të aksesojë në accountin e tij.

Kryetari i Bashkisë u shpreh se një problem që ndeshet për këto dy zona lidhet me ujësjellës kanalizimet, projekti gjerman i cili është anuluar prej pandemisë. Me projektin e ujërave të bardha

e të zeza bashkia del nga harta e qyteteve të përmytura dhe pas përfundimit tyre do të mund të dizenjohej komplet infrastruktura rrugore e qytetit dhe lagjeve. Janë lagjia “Nënë Tereza”, Shëngjini dhe Gocaj-Kakarriq që do të kenë ujësjellësin. Sipas tij këto projekte kufizojnë që të bëhen rrugë të reja në këto zona sepse duhen “zhbërë” sërish në momentin që do të bëhet ujësjellësi. Gjithashtu kryetari theksoi që do të zgjidhen edhe problematikat e telave në ajër, një pjesë e të cilëve nuk identifikohen, janë jashtë përdorimit por do të vendosen poshtë dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak do të priten të gjitha. Në Shëngjin janë bërë ndërhyrje me shetitoren, ndricimin, pastrimin por akoma nuk janë në standartin që synohet. Vitin e ardhshëm me të ardhurat edhe nga lejet e ndërtimit do të investohet edhe më shumë në rrugë rurale dhe aspekte të tjera, paralelisht edhe me investimet e qeverisë ku që nga viti 2024 do fillojnë 4-5 investime serioze si Milot-Balldre, Bypass i Shëngjinit etj. Kryetari përmendi që fillimisht në Bashki janë gjetur zero projekte ndërsa sot janë rreth 20 të tillë, ku disa janë aplikuar tek FSHZH, disa do të aplikohen në thirrjet e BE-së etj. Me investimet e parashikuara do të konfigurohet gjithë sistemi i rrugëve të qytetit, sinjalistika horizontale e vertikale, gjitha lulishtet dhe hapësirat ku do të planizohen instalacione të ndryshme që qyteti të ketë një imazh bashkëkohorë. Pa përfunduar projekti gjerman nuk mund të bëhen ndërhyrje sepse pastaj për shkak të ndërhyrjeve duhet zhbërë sërish. Së fundmi theksoi që është kërkuar që Bashkia Lezhë të rrisë taksën e ujit, për të cilën ai nuk dakordësohet por çështja do të kalojë në Këshill.

Mendime/diskutime

E para që kërkoi të merrte fjalën ishte këshilltarja Znj. Alfrida Marku por në replikë kryetari theksoi se si anëtare e këshillit mund të diskutojë në mbledhjen e këshillit për këtë tematikë sepse prioritet kanë grupet e interesit ku përfshihen banorët, bizneset e zonës dhe qëllimi i takimit nuk janë diskutimet politike.

1. (Alfrida Marku) Në fjalën e saj shprehu se është njoftuar për zhvillimin e konsultimit publik me dy njësi administrative, përkatësisht me rreth 43 mijë banorë dhe pretendohet që problematikat e tyre të ezaurohen në këtë takim ku 80% janë administratë. Znj. Marku theksoi se në mbledhjet e këshillit ka kërkuar të bëhen grafik që në çdo njësi administrative, zonë, fshat të takohen të gjithë nga afër për të evidentuar problematikat ndërsa praktikisht vendimet po merren nga zyrat e Bashkisë.

Në vijim të diskutimit kryetari u shpreh se më parë nuk janë zhvilluar fare konsultime, njoftimi për konsultim është bërë publik dhe takimi ka qenë i hapur për të gjithë. Të pranishëm janë përfaqësues nga biznesi, banorë, shoqatat e ndryshme të gjithë pjesë e komunitetit, edhe administrata sepse jeton në këtë qytet.

Gjithashtu Znj. Marku theksoi se nuk kishte pasqyrim të paketës fiskale. Sipas saj u përmend që janë ulur taksat por në fakt ato janë rritur, për të njëjtin biznes në vitin 2022 dhe vitin 2023 janë paguar tarifa të ndryshme dhe minimalisht janë rritur taksat 30%.

Në përgjigje të kësaj çështje kryetari u shpreh se paketa fiskale nuk ka pësuar asnjë ndryshim. Për disa biznese është rritur pagesa sepse kur janë bërë matjet në terren ka rezultuar se është bërë faturimi njësoj si për një biznes me 100 m² me një që kishte 1000 m². Sipas tij, janë bërë verifikimet konkrete dhe është reflektuar në pagesë sipas sipërfaqes, prandaj kërkoi që të specifikohet se cila taksë është rritur.

Znj. Marku: "...propozoj që për çdo biznes që drejtohet nga të rinj 18-35 vjeç Bashkia, Këshilli i Bashkisë të miratojë 0 taksë dhe tarifë vendore, për këtë vit dhe 4 vitet e ardhshme."

Kryetari: "...është e drejta jote që të bësh një propozim të tillë për ndryshimin e kësaj takse por jo këtu, duhet bërë në Këshill sepse këtu po flasim me të tjerë njereëz që preken."

Në fjalën e tij kryetari theksoi që ky sygjërim mund ta bëhet tek mbledhjet e Këshillit Bashkiak për të cilën duhet të binden anëtarët e tjerë, në konsultim publik nuk bëhet politikë.

Në replikë drejtori i taksave u shpreh se për të njëjten periudhë janar-shtator 2022 dhe janar-shtator 2023 janë mbledhur 26 milion lekë të reja më tepër.

2. (I. Z.-Banor) u shpreh se takimi u kthye në një mbledhje këshilli dhe të pranishmit kanë ardhur për buxhetin dhe paketën fiskale. Si qytetar i Lezhës shtroi si kërkesë ndarjen e kanaleve të ujërave të bardha e të zeza si dhe problemin e varrezave të qytetit.

Në përgjigje të çështjes, kryetari evidentoi 3 variante për çështjen e varrezave, por duhet përcaktuar edhe një pagesë që të kalojë në administrim të bashkisë dhe ti jepet një zgjidhje përfundimtare. Ai përmendi që ka pasur abuzime me qiratë, taksat, varrezat etj.

3. (A.LI) u shpreh se është e pakënaqur me gjendjen aktuale me funksionimin e demokracisë, lirinë e fjalës.

Në replikë kryetari tha se qëllimi i takimit nuk është të bërit politikë por diskutimi i paketës fiskale.

4. (Përfaqësues i biznesit të vogël) u shpreh se nuk ka pasur rritje taksash por vetëm ndryshime për shkak të matjes së sipërfaqeve në metër katror, madje ka pasur edhe ulje.

Kryetari theksoi sërish rëndësinë e tematikës së takimit për evidentimin e nevojave që ka komuniteti për investime, vërenjtje për taksa të caktuara, sygjërimet për ndërhyrje në X zone dhe qëllimi i takimit nuk është diskursi politik.

5. (Banor i Lezhës) Shtroi si problem çështjen e shërbimeve, sepse flitet për taksa por duhet fillimisht shërbim i mirë, nuk ka konkurrencë tregu, ka cilësi të dobët të produkteve. Sipas tij nuk funksionojnë mirë strukturat, cilësia e punimeve nuk është e mirë, specifikisht rruga te Komisariati.

Në vijim të këtij diskutimi kryetari shprehu se ai është projekt i FSHZH dhe nuk është marrë në dorëzim për shkak të cilësisë së dobët të punimeve, i njëjti problem edhe për tratuarin në lagjen

“Gurra”. Kurse trotuari në Bulevardin Qëndror i cili është bërë nga Bashkia me burimet e veta njerëzore, është me cilësi shumë të mirë.

6. (Përfaqësues i shoqatës së të verbërve) u shpreh se ndryshimi në rrugët e qytetit është i dukshëm por ngriti çështjen se sa u shërbejnë të verbërve këto rrugë, me aksesorët që disponojmë duke shtuar mundësitë që te kenë pavarësi dhe siguri në lëvizje. Ai sygjeroi që në planet e reja të gjendet mundësia për të menduar edhe më shumë për këto shtresa, duke kërkuar nga kryetari që të shikohen me përparësi, jo me shpenzime të mëdha në bashkëpunim me shoqaten e të verbërve. Ai u shpreh i kënaqur për vëmendjen me buxhetin e fundit ku është përfshirë edhe kjo shtresë, nëpërmjet angazhimit në aktivitetete të ndryshme.

Kryetari u shpreh që qyteti do të kalojë në një intensitet punimesh dhe së bashku me projektuesit do të bëhen përpjekje për të krijuar lehtësira të mundshme për këtë kategori. Për pjesën e aktiviteteteve është bërë maksimumin për angazhimin në aktivitete gjithëpërfshirëse.

Kryetari ftoi të pranishmit që të marrin pjesë online në mbledhjen e Këshilit Bashkiak për të ballafaquar taksat si kanë qenë e si janë dhe theksoi që ndryshimet në taksa kanë ndodhur vetëm pas verifikimit në terren.

Takimi u mbyll nga kryetari pas ftesës për ndjekjen e takimit online të KB.

¹Kohëzgjatja: Rreth 80 minuta

Pjesëmarrës: 110 persona Femra: 37

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diaspores, Komunikimit dhe Transparencës

Elson Frroku



Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik

Gjystina Nik-ulaj



Drejtorja e Financës dhe Buxhetit

Xhemal Haxhia



¹ **Shënime:**

- Numrat rendor (1,2,3,..) tregojnë numrin dhe radhën e personave të cilët kanë diskutuar gjatë konsultimit. Në kllapa janë shënuar emrat, inicialet apo zona/ kategoria që përfaqëson.
- Në thonjëza (“”) janë të vendosura citimet e diskutuesve.
- Theksojmë se procesverbali është hartuar kryesisht mbi bazën e perifrazimeve dhe përmbledhjes. Në pjesën e parë të procesverbalit në çdo paragraf paraqiten perifrazime sipas radhës së prezantimeve. Në pjesën e dytë, parashtrohen fillimisht sygjerimet/mendimet nga audienca dhe pastaj sipas rasteve replika përkatëse.

